



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA PATOS
KRYETARI**

Nr. 966 Prot.

Patos, më 02 / 04 / 2025

VENDIM

Nr. 71, datë 02 / 04 / 2025

**PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE TË SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PWR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1/1 gërma “b” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të nenit 78 pika 1, neni 79 pika 1, 2, 3 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, në kushtet kur në territorin e bashkisë Patos nuk ka vende publike sipas Udhëzimit të sipër përmendur,

VENDOSA:

1. Afishimi i materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 do të lejohet deri në një distancë prej 5 (pesë) metër nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.
2. Afishimi do të bëhet jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve, me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore të marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
3. Subjektet zgjedhore që nuk janë dakort me këtë vendim, kanë të drejtë të ankohen në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.
4. Afishimi i materialeve propagandistike jashtë vendeve të caktuara me këtë vendim, sipas nenit 79 të Kodit Zgjedhor, do të sjellë heqjen e tyre nga Policia Bashkiake dhe të ndëshkohen për kundërvajtje administrative.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Subjektet zgjedhore që do të marrin pjesë në Zgjedhjet për Kuvend dhe Policia Bashkiake.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë Patos.


KRYETAR
Faton Duro